

KRU **Hidroregjioni Jugor** sh.a. Prizren

Adresa: Wesley Clark p.n., 20000 Prizren
email: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com

Bordi i Drejtorëve në Kompaninë Rajonale të Ujësjetjesit "Hidroregjioni Jugor" SH.A me seli në Prizren, në përputhje me nenin 31 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087 për raportet vjetore dhe tremujore dhe nenin 18 Ligjit Nr.04/L-111 Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në mbledhjen e mbajtur me datë 05.04.2024, mori këtë:

VENDIM

RAPORTIN VJETOR-2023

Bordi i Drejtorëve njëzëri miratoi Raportin Vjetor për vitin 2023 në mbledhjen e I (parë) të mbajtur me datë 05.04.2024

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri	UD. Kryeshef Ekzekutiv Fadil Berisha	Kryesuesi i BD Ismet Vrapçani
Nënshkrimi		
Data	05.04.2024	05.04.2024





KRU **Hidroregjioni Jugor** sh.a. Prizren

Adresa: Wesley Clark p.n., 20000 Prizren
email: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
DEVERIA - VLADA - GOVERNMENT	
MINISTRIA E EKONOMISE MINISTARSTVO EKONOMIJE MINISTRY OF ECONOMY	
Njesia Org. Org. Jedin. Org. Unit	Nr. Prof. Br. Prof.
0113	3589
Nr. - kopjeve Broj. kopijica No. pages	Prof.No. Datum Date
33	08.04.24
PRISHTINE A	NO.1

KOMPANIA RAJONALE E UJESJELLËSIT REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNABDEVANJE	
»HIDROREGJIONI JUGOR« SH.A.D.D.	
Nr.	1339
Dt.	05.04 2024
PRIZREN	

RAPORT VJETOR 2023

KRU "HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A. – PRIZREN

PËRMBAJTJA

I.	QËLLIMI	4
II.	METODOLOGJIA	4
III.	RAPORT I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE	5
IV.	AKTIVITETET E KRYESHEFIT EKZEKUTIV	7
V.	DEPARTAMENTI I UJIT TË PIJES	7
5.1	PRODHIMI m3.....	7
5.2	SITUATA E FURNIZIMIT.....	8
5.3	AKTIVITETET KRYESORE.....	8
5.3.1	AKTIVITETET PËR ZVOGLIMIN E HUMBJEVE TEKNIKE	10
5.3.2	MIRËMBAJTA - SANIMI I DEFЕКTEVE	11
5.3.3	SERVISIMI I UJËMATËSAVE DHE DETEKTIMI.....	11
5.3.4	CILËSIA E UJIT	12
VI.	DEPARTAMENTI KOMERCIAL	13
6.1	PERFORMANCAT - 2023	13
6.1.1	NUMRI I KONSUMATORËVE.....	13
6.1.2	FATURIMI – m3.....	14
6.1.3	FATURIMI – €.....	14
6.1.4	ARKËTIMI – €.....	15
6.2	KOMENTET KRYESORE NGA DEPARTAMENTI KOMERCIAL.....	16
6.2.1	AKTIVITETET KRYESORE.....	16
6.2.2	ANKESAT TEKNIKE DHE KOMERCIALE.....	16
6.2.3	INSPEKTIMI DHE SHKYÇJA.....	17
VII	DEPARTAMENTI I FINANCAVE.....	17
7.1	KOMENTET KRYESORE NGA DEPARTAMENTI I FINANCAVE	17
7.1.1	AKTIVITETET KRYESORE.....	17
7.1.2	ARSYESHMËRIA E SHPENZIMEVE.....	18
VIII	PERFORMANCAT OPERATIVE DHE FINANCIARE.....	21
8.1	PERFORMANCAT 2022-2023	21

8.2	CAQET - PB- 2023 – KRU „HIDRORERGJIONI JUGOR” SH.A-PRIZREN	Gabim! Shenja e referimit e padefinuar.
8.3	CAQET – ARRU – KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A-PRIZREN.....	22
8.4	DRAFT PASQYRAT FINANCIARE – 2022-2023	22
IX	DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS	27
9.1	KOMENTET KRYESORE.....	27
9.2	ZYRA LIGJORE	28
X	DEPARTAMENTI I UN -ITUN	30
10.1	KOMENTET KRYESORE.....	30
10.1.1	FUSHËVEPRIMI I DEPARTAMENTIT TË -ITUN	30
XI	MASAT E PROPOZUARA - 2024	32
XII	ORGANOGRAMI	33

SHKURTESAT

ARRU	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
BD	Bordi i Drejtorëve
KA	Komisioni i Auditimit
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
KNMU	Këshillit Ndërmëtor për Ujëra
KRU	Kompania Rajonale e Ujësullësit
NJPMNP	Njësia për Politika e Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
UPF	Uji i pa-faturuar
SIG	Sistemi Informativ Gjeografik
SHUKOS	Shoqata e Ujësullësve dhe Kanalizimit të Kosovës
NJOU	Njësia Operative e Ujësullësit
ITUN	Impiant i Trajtimit të Ujit të Ndotur.
NP	Ndërmarrjet Publike
DP	Departamenti i ujit
DK	Departamenti Komercial
KfW	Banka gjermane për zhvillim

I. QËLLIMI

Me anë të Raportit vjetor (gjithëpërfshirës) për vitin 2023, Bordi i Drejtorëve, Menaxhmenti dhe të punësuarit e tjerë në Kompaninë Rajonale të Ujit "Hidroregjioni Jugor" sh.a. paraqesin të gjitha faktet reale, sukseset, dështimet, vështirësitë, sfidat etj., që e kanë shoqëruar punën e ndërmarrjes prej datës 01.01.2023 deri më 31.12.2023.

Ky raport shërben për të vënë në dijeni me të gjitha aktivitetet që janë ndërmarrë nga të gjitha palët e interesit, në rend të parë Ministrinë e Ekonomisë në cilësinë e pronarit të aksioneve, Bordit të Drejtorëve, Autoritetet tjera të pavarura, të punësuarit në ndërmarrje, konsumatorët, bankat, donatorët si dhe të gjithë të interesuarit e tjerë.

Gjithashtu, përmes këtij Raporti, menaxhmenti synon të ofrojë transparencën maksimale, duke publikuar të gjitha aktivitetet që e kanë përcjellë punën e ndërmarrjes gjatë vitit 2023. Parimi themelor që mendohet të arrihet me këtë Raport është edhe llogaridhënia përpara të gjithëve, veçanërisht palëve të interesit të implikuar në këtë proces.

II. METODOLOGJIA

Raporti është përpiluar duke marrë për bazë, Ligjin Për Ndërmarrjet Publike (NP), Kodin e Etikës dhe Qeverisjës Korporative për Ndërmarrjet Publike, Udhëzuesin e Auditimit të Brendshëm për Ndërmarrjet Publike në Kosovë, si dhe udhëzues të raportimeve nga ARRU (Autoriteti Rregullativ i Ujërave)

Po ashtu është marrë për bazë edhe përvajtjet pozitive të Raportëve vjetore

paraprake, njohurive empirike si dhe formave dhe formateve të shumta të raportimeve brendshme për menaxhmentin dhe raportimeve të jashtme për palët e interesit etj.

Me qëllim që Raporti të jetë i qartë dhe më i kuptueshëm për të gjithë është ndërtuar në bazë të:

Pjesës tekstuale (përshkruese- narrative),

Pjesës së tabelave- shifrave (numrave) dhe

Pjesës së grafikeve

Në Raport, janë bërë krahasimet me vitin paraprak (2022) dhe me Planin e biznesit për vitin 2023, si dhe me caqet e miratuara nga ARRU, bazuar në aplikimin tarifor për KRU-të

Raporti merr në konsideratë dhe është përmbledhje përkatësisht sintetizim i raporteve analitike të Departamenteve dhe Autoriteteve të tjera brenda KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a. (Raportëve mujore dhe tre mujore të të gjitha shërbimeve)

III. RAPORT I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

Emrat e drejtorëve të bordit të drejtorëve

1. **Feim Fetoshi** - **Kryesues i Bordit**
2. **Mirlinda Morina** - **Anëtare e Bordit (Kryesuese e KA)**
3. **Hysni Çanta** - **Anëtar i Bordit**
4. **Biljal Karadolami** - **Anëtar i Bordit**
5. **Naim Kukaj** - **Anëtar i Bordit**
6. **Arben Hajrizi** - **Anëtar i Bordit (I Dorëhequr nga data 11. 11. 2023.)**

Numri i takimeve të Bordit të Drejtorëve gjatë vitit 2023

Raporti vjetor i Bordit të Drejtorëve në KRU "Hidroregjioni Jugor" SH.A në Prizren, në formë përmbledhëse përfshinë aktivitetet kryesore të Bordit të Drejtorëve të realizuara gjatë muajve Janar - Dhjetor 2023.

Bordi i Drejtorëve gjatë muajve Janar - Dhjetor 2023 ka mbajtur gjashtëmbëdhjetë (16) takime të rregullta mujore si dhe tre (3) takime të jashtëzakonshme.

KRU „Hidroregjioni Jugor” SH.A Prizren është duke u udhëhequr nga Bordi i Drejtorëve i emëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendim Nr. 04/92 të datës 10.08.2022.

Gjatë vitit 2023 Bordi i Drejtorëve ka mbajtur 16 takime të rregullta dhe 3 të jashtëzakonshme.

Në këto takime Bordi i Drejtorëve ka miratuar këto dokumente me rëndësi;

- Organogrami dhe sistematizimi i vendeve të punës në KRU Hidroregjioni Jugor
- Raporti operativ – financiar TM4 2022
- Provizionimi i llogarive të arkëtueshme për vitin 2022 të KRU Hidroregjioni Jugor Sh.A në Prizren sipas kërkesës së kompanisë.
- Raporti vjetor operativ dhe financiar për vitin 2022
- Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës si dhe koeficientet e pagave për të gjitha pozitat e punës në KRU Hidroregjioni Jugor Sh.A – Prizren
- Raporti mbi Hulumtimin e Kënaqshmërisë së Konsumatorëve për periudhën Janar – Dhjetor 2022 në zonën e shërbimit që e mbulon KRU Hidroregjioni Jugor
- Raporti operativ dhe financiar TM1 – 2023 të KRU Hidroregjioni Jugor
- Revidimi i Plani të veprimit dhe strategjia për zvogëlimin e UPF të
- Strategjia për zvogëlim të humbjeve të ujit 2023 – 2025 dhe Planin e Veprimit për implementimin e strategjisë për zvogëlimin e humbjeve të ujit për vitin 2023

- Kontrata aktuale e Sekretares së Kompanisë prishet apo shpërbëhet, respektivisht prishet vendimi i Bordit që e ka bërë kontratën e Sekretares, emërohet U.D Sekretare dhe shpallet konkursi për Sekretar/e të Kompanisë
- Revidimi i Plan – Biznesit 2023 – 2025.
- Raporti operativ dhe financiar TM2 – 2023
- Miratimi i Plan - Biznesi 2024 – 2026
- Shkarkimi i Kryeshefi Ekzekutiv dhe emërimi i UD Kryeshef Ekzekutiv
- Raporti operativ dhe financiar TM3 2023
- Rregullorja për matjen e ujit, instalimin dhe leximin e pajisjeve matëse të ujit.

Aktivitetet tjera të Bordit të Drejtorëve gjatë vitit 2023

- Bordi i Drejtorëve prej emërimit me datë: 10.08.2022 ishte në kontakt të vazhdueshëm me Menaxhmentin e Kompanisë.
- Në vazhdimësi ka kërkuar dhe është njoftuar, në kontakt direkt por edhe në formë të shkruar, për gjendjen dhe zhvillimet në kompani.
- Është mbikëqyrë menaxhimi kompanisë dhe janë dhënë këshillat e nevojshme për Kryeshefit Ekzekutiv.
- Në takimet e rregullta janë mbikëqyrë të gjitha ecuritë e biznesit, mbarëvajtja e tyre sipas vendimeve të Bordit si dhe aspekti ligjorë i vendimeve të Menaxhmentit të kompanisë. Lidhur me këtë Bordi i Drejtorëve është i informuar për të gjitha vendimet dhe zhvillimet e rëndësishme.
- Është bërë shqyrtimi dhe aprovimi i raporteve tremujore për vitin 2023 (duke u bazuar në raportet mujore); dhe në kornizën ligjore të Ligjit për NP.

Raport vjetor i punës së Komisionit të Auditimit për vitin 2023.

Raporti vjetor i Komisionit të Auditimit të KRU" Hidroregjioni Jugor" SHA në Prizren, në formë përmbledhëse përfshin aktivitetet kryesore të Komisionit të Auditimit të realizuara gjatë vitit 2023.

Bazuar në procesverbalet zyrtare të mbajtura, gjatë këtij viti, janë mbajtur 10 takime të Komisionit të Auditimit. Po ashtu, shumë çështje janë shqyrtuar drejtpërdrejtë në takimet e rregullta të Bordit të Drejtorëve.

IV. AKTIVITETET E KRYESHEFIT EKZEKUTIV


V. DEPARTAMENTI I UJIT TË PIJES

5.1 PRODHIMI m3

PRODHIMI- 2022-2023 – REALIZIMI I CAQEVE- 2023

Tabela nr. 1 – Prodhimi – 2022-2023 dhe Caqet 2023

JANAR- DHJETOR - 2022-2023							
PRODHIMI - m3							
NJËSIA PUNUESE	2022	2023	2022/2023		PB-2023	REALIZIMI I PB - 2023	
	m3	m3	m3	%	m3	m3	%
			Ndryshimi	Ndry-%	m3	Ndryshimi	Ndry-%
PRIZREN	11,624,550	23,219,584	11,595,034	99.7%	20,770,806	2,448,778	11.8%
SUHAREKË	2,798,275	4,542,743	1,744,468	62.3%	4,285,285	257,458	6.0%
MALISHEVË	1,431,764	2,615,488	1,183,724	82.7%	2,798,262	-182,774	-6.5%
DRAGASH	996,303	957,996	-38,307	-3.8%	1,026,715	-68,719	-6.7%
TOTAL	16,850,892	31,335,811	14,484,919	86.0%	28,881,068	2,454,743	8.5%



5.2 SITUATA E FURNIZIMIT

Furnizimi i konsumatorëve me ujë të pijes për periudhën Janar – Dhjetor 2023, në nivel rajonal, duke përfshirë të gjitha njësitë punuese e operuese, ka qenë kryesisht i rregullt, me ulje presioni në disa zona më problematike dhe aplikimin e reduktimeve të furnizimit. Përjashtimet e veçuara janë shfaqur në disa zona të NJP Prizren (Zhur dhe Shkozë, Landovicë lagjja Tusus, Bazhdarane,), Suharekë (Gjinoc, Sallagrazhde dhe zona Garibaldi në qytet) Malishevë (Drenoc dhe Bajë) dhe Dragash (Plavë dhe Brezne) për shkak të infrastrukturës së pavolitshme ekzistuese të rrjetit shpërndarës, tej konsumit sezonal-keqpërdorimeve dhe shfrytëzimit joracional, mungesës së energjisë elektrike (prishjet në rrjetin distributiv – KEDS) dhe mungesa të pjesshme të furnizimit në disa lokalitete nga prishjet teknike në rrjetë, infrastrukturës elektropomuese dhe faktorëve tjerë eventual.

5.3 AKTIVITETET KRYESORE

- Raportet e rregullta, raportet e veçanta dhe specifike, përgjigjet, shkresat, komentet dhe shkëmbimet përmes komunikimeve elektronike e fizike për menaxhmet, KE, BD, ARRU, IM, KNMU dhe Institucionet e agjencionet tjera monitoruese dhe ndërvepruese në sektorët e ujit dhe energjisë në funksion të përgjegjësive dhe përmbushjes së standardeve të shërbimit.
- Takimet me institucionet komunale, qeveritare, institucione financiare donatore, me konsumatorë, palë tjera të interes, etj.
- Aplikimi dhe procedimi i kërkesave, ankesave dhe shkresave zyrtare që lëshon DUP - Përgjigjeve në kërkesa, Dhënia e kushteve teknike, Lejeve, Vendimeve dhe Pelqimeve konform Rregulloreve të zbatueshme të Kompanisë.
- Përpunimi final i Rregullores për sistematizim, nivelizim dhe përshkrim të detyrave të punës për stafin e kompanisë në përgjithësi dhe stafin e DUP-së në veçanti.
- Konsolidimi i divizioneve, seksioneve dhe shërbimeve përkatëse pranë DUP konform rregullores së miratuar.
- Menaxhimi, procedimi, mbikqyrja dhe procesimi i projekteve të investimeve kapitale vetanake sipas planifikimeve të PB 2023 dhe projekteve tjera investive për furnizime e shërbime të Kompanisë, kompletimi i dokumentacioneve tekniko-investive, procedimi për prokurim dhe përpilimi i raportit final investiv – 19 projekte - shih pasqyrën detale investive 2023.
- Propozimet, procedimet dhe mbikqyrja e projekteve të investimeve kapitale donatore sipas planifikimeve të PB 2023 dhe projekteve e aktiviteteve tjera investive sipas kërkesave dhe nevojave të shfaqura nga shërbimet e kompanisë, konsumatorëve dhe institucioneve tjera si objektiv konsistent në avansimin e funksionimit dhe efikasitetit të Kompanisë me theks të veçantë:
 1. PIF Projektpropozimet për investime kapitale për Qeveri – sektori i mjedisit pranë MMPHI-së – 4 projekte:

- Instalimi I sistemit të panelave solar – fotovoltaik për 4 komunitat (Prizren, Suharekë, Malishevë dhe Dragash).
 - Konstruktimi i digës së Manastiricës
 - Monitorimi dhe automatizimi I sistemeve të ujit përmes SCADA
 - Zëvendësimi I rrjetit të ujësjellësit nga përmbajtja azbest cement në polietilen për qytetin e Prizrenit.
2. KASH – projektetpropozime kapitale për NJPMNP - ME – 12 projektpropozime.
 3. Projektet investive nga komunitat e qeveria–mbikqyrja, asistimi dhe participimi – 5 projekte.
- Harmonizimi i projekteve investive dhe përpilimi e finalizimi i projektpropozimeve teknike të përgatitura nga DUP me të gjitha Institucionet financiare vendore, komunale (Prizren, Suharekë, Malishevë dhe Dragash), e fonde tjera përmes përpilimit, monitorimit dhe kontributit në realizimin e Marrëveshjeve të bashkëinvestimit apo praktikave të ngjajshme.
 - Gjatë vitit 2023 janë finalizuar 7 Marrëveshje bashkëfinancimi me komuna dhe një marrëveshje vetëfinancimi nga ME:
 1. Marrëveshje për bashkëfinancimin, nr. 400/16.02.2023, me emërtimin: “Projekti studimor dhe investiv për furnizim me ujë të pijes për komunën e Malishevës” – 70,000.00 €.
 2. Marrëveshje për bashkëfinancimin, nr. 401/16.02.2023, me emërtimin: “Investimi në rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësit, shtimin e kapaciteteve ujore dhe zgjerimin e sistemit të ujësjellësit në disa zona dhe lokalitete të komunës së Malishevës” – 150,000.00 €.
 3. Marrëveshja nr. 402/16.02.2023, me emërtimin: “Ofrimi i shërbimeve specifike nga KRU HRJ sipas kërkesave të komunës së Malishevës.
 4. Marrëveshja nr. 677/14.03.2023, me emërtimin: “Vazhdimi i gypsjellësit ekzistues PE Ø 250 mm në tranzitin e ri të qytetit të Prizrenit.
 5. Marrëveshja nr. 822/30.03.2023, me emërtimin: “Ndërtimi i infrastrukturës së re të rrjetit të ujësjellësit në rrugën ‘Ibrahim Mazreku’ – Malishevë” – 63,120.00 €.
 6. Marrëveshje me Qeverinë e Kosovës – ME, nr. 1898/02.06.2023, për financimin e dy projekteve kapitale:
 - Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin "Gërçar", Komuna e Prizrenit Vlera investive -115,000.00 Euro.
 - Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në rrugët : "Junuz Emre" dhe "23 Prilli (Sylejman Drini",Prizren. Vlera investive - 55,000.00 Euro.
 7. Marrëveshja nr. 1898/02.06.2023, me emërtimin: “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në lagjet e fshatit Bllacë dhe zonat e lokalitetet Brenda zonës së mbulueshmërisë” – 420,000.00 €.
 8. Marrëveshje për bashkëfinancimin e projektit me emërtimin:
 - Furnizimi me pjesë fazonike hidroteknike për projektin “Ndërtimi i infrastrukturës së re të rrjetit të ujësjellësit në rrugën ‘Ibrahim Mazreku’ – Malishevë”. Vlera investive – 28,159.59 €
 - Furnizimi me elektropompa shtytëse për stacionin e pompimit – Bajë, komuna e Malishevës. Vlera investive – 43,000.00 €

- Revidimi, kompletimi i materialit për Draftin final për aprovim nga BD të dokumenteve:
 - Revidimi i PB 2023-2025
 - Strategjia për zvogëlimin e humbjeve të ujit 2023-2025
 - Plani i veprimit për implementimin e strategjisë për zvogëlimin e humbjeve të ujit për vitin 2023.
- Përgatitja e projektdokumentacionit investiv për realizim të marrëveshjes bashkëinvestuese me komunën e Dragashit për 3 projekte:
 - Rehabilitimi i rrjetit të vjetër të ujësjellësit në Dragash.
 - Ndarja e lokacionit komunal për ndërtimin e objektit administrativ e operativ për NJP Dragash.
 - Ofrimin e shërbimeve specifike nga Kompania sipas nevojave dhe kërkesave të Komunës së Dragashit.
- Procesimi i projektit të efijencës së energjisë mbështetur nga KFW për energjinë alternative përkatësisht instalimin e pasqyrave fotovoltaike (solare) në 6 lokacione të përzgjedhura të NJP të Kompanisë.
- Realizimi I infrastrukturës pompuese dhe sigurimi I furnizimit me ujë të pijes për pushimore nga st. Pomp. – Sozi Nashec.
- Detalizimi final i Marrëveshjes ekzistuese me Telekomin e Kosovës për shërbime telekomunikuese për punëtorët e Kompanisë.
 - Inicimi i procedurës së prokurimit dhe kontraktimi për „Furnizim me elektropompa dhe paisjeve komanduese e komunikuese“.

5.3.1 AKTIVITETET PËR ZVOGLIMIN E HUMBJEVE TEKNIKE

- Përpilimi i planeve operative ditore dhe periodike me të gjitha shërbimet përkatëse dhe intervenimet në sanimin e prishjeve në rrjetë, rrjedhjeve të pakontrolluara, shkyçjen e lidhjeve ilegale, etj.
- Mbështjetja për konsolidim të divizionit për UPF.
- Monitorimi dhe mirëmbajtja e ujëmatësve të prodhimit në të gjitha pikat furnizuese në nivel të kompanisë.
- Detektimi i rrjetit të ujësjellësit, ndërrimi i ujëmatësve dhe ndarja e zonave për detektim për zvogëlimin dhe eliminimin optimal të humbjeve teknike.
- Rehabilitimin e rrjetit të vjetër të qytetit dhe segmenteve tjera në zonën e mbulueshmërisë me prishje të shpeshta dhe jofunksionalitet të duhur sipas të dhënave të gjeneruara nga sistemet monitoruese aplikative, shërbimit operativ dhe matjeve në teren përmes investimeve të vazhdueshme vetanake dhe bashkëinvestimeve me komunat, qeverinë dhe institucionet tjera financiare.
- Investimi i vazhdueshëm në infrastrukturën fizike dhe humane me qëllim të ofrimit të shërbimeve cilësore në tërë fushëveprimtarinë e Kompanisë.

5.3.2 MIRËMBAJTA - SANIMI I DEFEKTEVE

Tabela nr. 2 – Sanimi i defekteve- 2023

Njësia Operative	Ujësjetësi - uji i pijes	Kanalizimi	Total
Prizren	2,038	479	2,517
Suharekë	393	129	522
Dragash	59	26	85
Malishevë	298	42	340
Total	2,788	676	3,464

5.3.3 SERVISIMI I UJËMATËSAVE DHE DETEKTIMI

Tabela nr. 3 – Servisimi i ujëmatësve- 2023

Aktivitetet/Grupet - e menaxhuar nga Departamenti Teknik		
Grupet	Aktivitetet e grupeve gjatë muajit Janar-Dhjetor - 2023	
Kalibrimi i ujëmatësve (kalibrimi)	1065	riparime të ujëmatësve
	27	ekspertiza
Ndërrimi i ujëmatësve (D-M)	2053	Inspektime të konsumatorëve
	1191	ndërrime të ujëmatësve
	349	riparime të defekteve gjatë ndërrimit
Detektimi i rrjetit	697	detektime
	451	defekte të gjetura
	16,555	rrjetë i detektuar (m)
Pllombimi	1196	pllombim dhe kontrata
	3227	pamundësia e qasjes te konsumatorët
	177	kërkesa nga konsumatorët për pllombim

5.3.4 CILËSIA E UJIT

Kontrrolli permanent i prezencës së klorit residual në kroje në qytet dhe në fshatra.

Kontrrolli permanent i kualitetit të ujit në burime dhe në puseve të cilat shfrytëzohen për momentin.

Kontrrolli i rregullt i stacioneve të klorinimit për punën e procesit të klorinimit dhe paisjeve.

Furnizim i stacioneve të klorinimit me Hipoklorit të Natriumit në të gjitha fshatrat.

Marrja e mostrave sipas Planit për monitorim të cilësisë së ujit.

Riparim i sistemit të klorinimit të "Galeria I" dhe në Novakë.

Nënshkrimi i marrveshjes së mirkuptimit me ISHP-Prizren për kryejën e analizave dhe analizat C të cilat laboratorit i ynë nuk ka mundësi të bëjë, ato bëhen në Prishtinë përmes ISHP-së Prizren.

Tabela nr. 4 – Analizat bakteriologjike - IKSHIP- 2023

Njësia	Lloji i ujit	Nr. i mostrave bakteriologjike	Nr. i mostrave që nuk përgjigjen
Prizren	Burim	33	0
	Ujësjiellës	1.746	3
Suharekë	Burim	11	0
	Ujësjiellës	246	1
Dragash	Burim	7	0
	Ujësjiellës	108	4
Malishevë	Burim	10	0
	Ujësjiellës	242	6
Totali	Burim	61	0
	Ujësjiellës	2.342	14

Vërejtje: Numri i analizave të mostrave bakteriologjike të marra në rrjetin e ujësjiellit është **2342** mostra, ku **14** prej mostrat nuk i përgjigjen standardeve të ISHP


VI. DEPARTAMENTI KOMERCIAL

6.1 PERFORMANCAT - 2023

6.1.1 NUMRI I KONSUMATORËVE

Tabela nr. 5 – Numri i Konsumatorëve- 2022-2023 – Caqet 2023


NUMRI I FATURAVE TË LËSHUARA								
NR.	TË DHËNAT	JAN-DHJET - 2022	JAN-DHJET - 2023	NDRYSHIMI- 2022/2023	NDRYSHIMI- %	CAQET- 2023	NDRYSHIMI- CAQET-2023	NDRYSHIMI- %
1	Shtëpiak	49,855	52,035	2,180	4.4%	51,505	530	1.0%
4	Kom.-Indu.	6,324	6,585	261	4.1%	6,538	47	0.7%
7	Institucional	346	343	-3	-0.9%	359	-16	-4.5%
10	TOTAL	56,525	58,963	2,438	4.3%	58,402	561	1.0%



6.1.2 FATURIMI – m3

Tabela nr. 6 – Faturimi m3- 2022 -2023 – Caqet 2023


FATURIMI - m3								
NR.	TË DHËNAT	JAN-DHJET - 2022	JAN-DHJET - 2023	NDRYSHIMI- 2022/2023	NDRYSHIMI- %	CAQET- 2023	NDRYSHIMI- 2022/2023	NDRYSHIMI- %
1	Shtëpiak	6,672,420	6,778,431	106,011	1.6%	7,427,089	-648,658	-8.7%
4	Kom.-Indu.	678,327	771,192	92,865	13.7%	665,941	105,251	15.8%
7	Institucional	453,415	521,516	68,101	15.0%	518,284	3,232	0.6%
10	TOTAL	7,804,162	8,071,139	266,977	3.4%	8,611,314	-540,175	-6.3%



6.1.3 FATURIMI – €

Tabela nr. 7 – Faturimi €- 2022 -2023 – Caqet 2023


FATURIMI - €								
NR.	TË DHËNAT	JAN-DHJET - 2022	JAN-DHJET - 2023	NDRYSHIMI- 2022/2023	NDRYSHIMI- %	CAQET-2023	NDRYSHIMI- 2022/2023	NDRYSHIMI- %
1	Shtëpiak	4,036,928.54	4,119,857.06	82,929	2.1%	4,491,546.53	-371,689	-8.3%
2	Kom.-Indu.	779,425.70	871,448.56	92,023	11.8%	753,311.49	118,137	15.7%
3	Institucional	109,596.46	473,822.36	364,226	332.3%	455,732.76	18,090	4.0%
4	Të tjera	71,833.73	50,832.26	-21,001	-29.2%	14,460.00	36,372	251.5%
5	TOTAL	4,997,784.43	5,515,960.24	518,176	10.4%	5,715,050.78	-199,091	-3.5%



6.1.4 ARKËTIMI – €

Tabela nr. 8 – Arkëtimi €- 2022 -2023 – Caqet 2023

ARKËTIMI - €								
NR.	TË DHËNAT	JAN-DHJET - 2022	JAN-DHJET - 2023	NDRYSHIMI- 2022/2023	NDRYSHIMI- %	CAQET-2023	NDRYSHIMI- 2022/2023	NDRYSHIMI- %
1	Shtëpiak	3,846,606.72	4,178,475.75	331,869	8.6%	4,191,976.66	-13,501	-0.3%
2	Kom.-Indu.	819,523.79	851,200.99	31,677	3.9%	778,808.89	72,392	9.3%
3	Institucional	445,490.33	445,770.03	280	0.1%	528,822.07	-83,052	-15.7%
4	Të tjera	69,951.09	46,907.35	-23,044	-32.9%	14,460.00	32,447	224.4%
5	TOTAL	5,181,571.93	5,522,354.12	340,782.19	6.6%	5,514,067.62	8,286.50	0.2%



6.2 KOMENTET KRYESORE NGA DEPARTAMENTI KOMERCIAL

6.2.1 AKTIVITETET KRYESORE

- Kemi intensifikuar vizitat tek konsumatorët për arkëtimin e borgjeve
- Ka vazhduar aktiviteti i leximit të ujëmatësve, shtypjes dhe shpërndarjes së faturave të shërbimeve të ujësjellësit në teren brenda afatit ligjor të secili konsumatorë nga lexuesit.
- Janë rritur aktivitetet në plotësimin e standardeve të shërbimeve

6.2.2 ANKESAT TEKNIKE DHE KOMERCIALE

- Janë shqyrtuar të gjitha ankesat teknike ndërsa ankesat komerciale të konsumatorëve janë shqyrtuar sipas kohës dhe prioritetit të tyre.

Tabela nr. 9 – Ankesat teknike dhe komerciale -2023

1. Ankesat Teknike për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	3103
1.1 Rrjedhje e ujit	numër	1778
1.2 Mungese e ujit	numër	729
1.3 Rënie e presionit	numër	0
1.4 Cilësia e ujit	numër	0
1.5 Bllokimi i kanalizimeve	numër	512
1.6 Të tjera	numër	42
2. Ankesat Komerciale për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	878
2.1 Kontestim i borxhit, faturës	numër	535
2.1 Verifikim i leximit të ujëmatësit	numër	150
2.2 Kontestim i çmimit, faturës mujore	numër	15
1.6 Të tjera	numër	8

6.2.3 INSPEKTIMI DHE SHKYÇJA

Kanë vazhduar kontrollet në teren te konsumatorët nga ekipi i inspektimit dhe verifikimet tek konsumatorët dhe aktivitetet janë të prezantuara në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 10 – Inspektimi dhe shkyçja -2023

Njesite operative	Shperndarja e njoftimeve para fajmeruese per permbarim	Konsumatorët e legalizuar/regjistruar	Lidhjet e paligjshme te zbuluara	Nr. i shkyçjeve te lidhjeve te paligjshme dhe tjera	Verifikimi i leximit te ujëmatësve	Nr. i leximeve te gabuara	Rastet e dorezuar per gjykatë	Vizita nga ankesat/kerkesat konsumatoreve	Shuma e inkasuar nga borxhet e vjetra
Prizren	22.449	1.256	130	144	15,722	76	205	757	583,502.70
Suharekë	2.758	209	16	12	9,816	32	88	244	110,211.00
Malishevë	2.932	350	20	9	1,292	106	2	52	73,206.02
Dragash	17	26	7	7	182	10	2	6	250.00
TOTAL	28,156	1841	173	172	27,012	224	297	1,059	767,169.72

VII DEPARTAMENTI I FINANCAVE

7.1 KOMENTET KRYESORE NGA DEPARTAMENTI I FINANCAVE

7.1.1 AKTIVITETET KRYESORE

Ky raport përfshinë disa aktivitete nga shërbimi financiar në pika të shkurtra, aktivitete të cilat janë komfor rregullores së punës së kompanisë si dhe ligjeve në fuqi. Duke u nisur nga regjistrimet e rregullta dhe të drejta sipas ligjeve në Kosovë e deri te aktivitetet tjera për një performacë sa më të mirë të kompanisë, dhe disa nga to janë:

- Si çdo fillim vit, me përmbylljen e shënimeve financiare 2022, përgatitjen e raporteve financiare vjetore të kompanisë për ARRU, ATK, ASK, MZHE etj.
- Përgatitje e draft dhe finale të Pasqyrave Financiare 2022;
- Ofrimin e shënimeve të kërkuara për auditorët e kontraktuar, Audit Conto;


- Deklarimet ligjore ndaj ATK-së, për Tatimet në burim, të ardhura personale, tatimin e vlerës së shtuar, deklarimet e TM-së për korporatat e mëdha, si dhe deklarimet e pasqyrave financiare;
- Përgatitja e raporteve mujore financiare, si inkasimin, të hyrat dhe ato të shpenzimeve, gjithashtu edhe raportet tremujore për ARRU, ASK, Ministrinë;
- Kontrollimi dhe barazimi i të pagueshmeve dhe atyre të arkëtueshmeve,
- Hapja dhe përgatitja e pagave për muajt përkatës, kontrollim, barazim dhe verifikim të regjistrit të të punësuarve;
- Raportet ditore nga shërbimi i arkës, gjendjen e arkës në lidhje me inkasimet ditore, ato të amvisërisë, bizneseve, gjendjen e llogarive bankare, kontimin e tyre, barazimet etj;
- Kontrollimi dhe nënshkrimi i kërkesave për blerje, si dhe aprovimi i tyre për blerje;
- Kontrollimi dhe pranimi i faturave për blerjet si dhe regjistrimi i tyre në kontabilitet, pas kontrollimeve;
- Pagesa e furnitorëve, pas kontrollimit të blerjeve; barazimi i të pagueshmeve;
- Plotësimin e librave të blerjes dhe shitjes sipas ligjeve dhe formës standarde të kërkuar nga ATK, për muajt përkatës, mujor e tremujor;
- Raportimet tremujore ndaj Asgjësisë së Statistikave të Kosovës;
- Përgatitja e shënimeve për Rregullimin dhe Ri sistematizimin e vendeve të punës sipas Vendimit të Qeverisë së Kosovës dhe udhëzuesit të Këshillit Ndërmintor të NMPNP, në bashkëpunim me të gjitha Departamentet e Kompanisë dhe të njëjtat janë aprovuara nga Bordi i Drejtorëve dhe ka hyrë në fuqi nga muaji mars 2023;

7.1.2 ARSYESHMËRIA E SHPENZIMEVE

Tabela nr. 11 – Shpenzimet 2022-2023- Caqet 2023

SHPENZIMET - €								
NR.	TË DHËNAT	JAN-DHJET - 2022	JAN-DHJET - 2023	NDRYSHIMI- 2022/2023	NDRYSHIMI- %	CAQET-2023	NDRYSHIMI- 2022/2023	NDRYSHIMI- %
1	Shpenzimet Totale	4,128,566.28	4,689,047.15	560,480.87	13.58%	4,663,567.62	25,479.53	0.55%
2	Pagat	2,486,884.79	2,879,712.25	392,827.46	15.80%	2,934,379.83	-54,667.58	-1.86%
3	Rryma elektrike	934,692.08	1,016,147.70	81,455.62	8.71%	975,105.62	41,042.08	4.21%
4	Shpen. e derivateve	135,282.39	117,716.28	-17,566.11	-12.98%	100,739.71	16,976.57	16.85%
5	Mirem. dhe riparimet	167,858.18	185,992.06	18,133.88	10.80%	224,623.49	-38,631.43	-17.20%

6	Mir. e automjeteve	61,916.88	79,655.94	17,739.06	28.65%	53,966.87	25,689.07	47.60%
7	Shpen.e taksave	96,396.26	109,390.16	12,993.90	13.48%	102,001.65	7,388.51	7.24%
8	Kemikaliet	35,902.61	40,089.69	4,187.08	11.66%	38,778.57	1,311.12	3.38%
9	Shpenzimet e tjera	209,633.09	260,343.07	50,709.98	24.19%	233,971.88	26,371.19	11.27%



Shpenzimet operative të ndërmarrjes për vitin 2023, në krahasim me shpenzimet e vitit 2022, janë më të larta, më poshtë do t'i cekim disa nga pozicionet, të cilat kanë lëvizur më së shumti dhe arsyt e rritjes apo rënies së tyre;

- Nëse fillojmë nga pozicioni i shpenzimeve të pagave, në këtë pozicion, kemi rritje të shpenzimeve, në muajin mars 2023 kemi bërë nivelizimin e pagave, me vendim të bordit dhe kjo ka ndikuar në rritje totale të shpenzimeve të kësaj kategorie.
- Rritje kemi edhe te pozicioni i energjisë elektrike në krahasim me vitin e kaluar, pasi që në prill të vitit 2023, sipas vendimit të ZRRE-së, kemi rritje të tarifave të energjisë elektrike;
- Ndërsa te pozicioni i derivateve kemi rënie të shpenzimeve, për shkak se në vitin 2022 çmimet e derivateve ka qenë më të larta se sa 2023 dhe kjo është aryeja kryesore për rënie të këtyre shpenzimeve;
- Ndërsa te pozicioni i mirëmbajtjes dhe riparimeve, dhe mirëmbajtjen e pompave, kemi rritje të të shpenzimeve, sidomos në njësinë e Prizrenit, pasi që ka qenë nevoja më e madhe për intervenime në rrjet në mirëmbajtje dhe intervenime në defekte;

- Rritje kemi pasur edhe te pozicioni i mirëmbajtjes së automjeteve; arsyeja është se këtë vit janë shtuar edhe automjetet dhe nevoja për servisime të rregullta dhe defekte të ndryshme, ka qenë më e madhe;
- Edhe te shpenzimet e taksave kemi rritje, në krahasim me vitin e kaluar, pasi që shpenzimet për taksat e përmbaruesit kanë qenë më të larta në këtë vit në krahasim me vitin e kaluar, si dhe fatura mujore për ARRU-së dhe e anëtarësisë në SHUKOS kanë qenë më të larta;
- Gjithashtu rritje kemi edhe në kategorinë e shpenzimeve të kemikaleve, pasi që edhe tek kjo kategori kemi rritje të çmimeve kemikaleve;
- Ndërsa rritje të shpenzimeve kemi tek shpenzimet e kategorisë të tjera, pra në këtë kategori ku përfshihen shpenzimet administrative, të cilat ka qenë më të larta, shpenzimet të jashtme profesionale, siç janë shpenzimet për mirëmbajtje të softuerit, mirëmbajtje për GPS. Gjithashtu këtu përfshihen edhe shpenzimet e përfaqësimit, trajnimeve të ndryshme, shpenzimet e provizioneve, shpenzimet e gjobave të ndryshme etj;
- Pra si përfundim, shpenzimet për këtë vit, kanë qenë më të larta në krahasim me vitin 2022, për arsyet e cekura më lartë, pra për gjithë arsyet e cekura më lartë. Vlen të theksohet se në totalin e shpenzimeve vjetore operative, nuk janë të përfshira edhe disa shpenzime si, shpenzimet e amortizimit si dhe shpenzimet e provizionimeve të arkëtueshmeve.

VIII PERFORMANCAT OPERATIVE DHE FINANCIARE

8.1 PERFORMANCAT 2022-2023 KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A

Tabela nr. 12 – Performancat - 2022-2023- Caqet 2023

MUAJI	2023	2022	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %	CAQET-PB- 2023-	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
Prodhimi m3	31,335,811	16,850,892	14,484,919	86.0%	28,881,068	2,454,743	8.5%
Faturimi m3	8,071,139	7,804,162	266,977	3.4%	8,611,314	-540,175	-6.3%
Faturimi nga uji €	5,465,127.98 €	5,231,120.09 €	234,007.89 €	4.5%	5,700,590.78 €	- 235,462.80 €	-4.1%
Faturimi- te tjera €	50,832.26 €	71,833.73 €	- 21,001.47 €	-29.2%	14,460.00 €	36,372.26 €	251.5%
Faturimi Total €	5,515,960.24 €	5,302,953.82 €	213,006.42 €	4.0%	5,715,050.78 €	- 199,090.54 €	-3.5%
Inkasimi nga uji €	5,475,446.87 €	5,111,620.87 €	363,826.00 €	7.1%	5,499,607.62 €	- 24,160.75 €	-0.4%
Inkasimi - te tjera €	46,907.35 €	69,951.08 €	- 23,043.73 €	-32.9%	14,460.00 €	32,447.35 €	224.4%
Inkasimi Total €	5,522,354.22 €	5,181,571.95 €	340,782.27 €	6.6%	5,514,067.62 €	8,286.60 €	0.2%
Nr. i Konsumatorëve	58,963	56,525	2,438	4.3%	58,402	561	1.0%
% e inkasimit	100.19	97.72	2	2.5%	96.47	4	3.9%
Shpenzimet	4,689,047.15 €	4,128,566.28 €	560,480.87 €	13.6%	4,663,567.62 €	25,479.53 €	0.5%
Pagat	2,879,712.25 €	2,486,884.79 €	392,827.46 €	15.8%	2,934,379.83 €	- 54,667.58 €	-1.9%
Rryma elektrike	1,016,147.70 €	934,692.08 €	81,455.62 €	8.7%	975,105.62 €	41,042.08 €	4.2%
Shpe. e derivateveve	117,716.28 €	135,282.39 €	- 17,566.11 €	-13.0%	100,739.71 €	16,976.57 €	16.9%
Miremb. Dhe riparimet	185,992.06 €	167,858.18 €	18,133.88 €	10.8%	224,623.49 €	- 38,631.43 €	-17.2%
Miremb, e automjeteve	79,655.94 €	61,916.88 €	17,739.06 €	28.6%	53,966.87 €	25,689.07 €	47.6%
Shpen. E taksave	109,390.16 €	96,396.26 €	12,993.90 €	13.5%	102,001.65 €	7,388.51 €	7.2%
Kemikalet	40,089.69 €	35,902.61 €	4,187.08 €	11.7%	38,778.57 €	1,311.12 €	3.4%
Shpenzimet tjera	260,343.07 €	209,633.09 €	50,709.98 €	24.2%	233,971.88 €	26,371.19 €	11.3%
Uji I pafaturuar në m3	23,264,672	9,046,730	14,217,942	157.2%	20,269,754	2,994,918	14.8%
Uji I pafaturuar ne %	74.24	53.69	21	38.3%	70.18	4	5.8%
Mbulimi operativ	1.18	1.26	0	-6.3%	1.18	0	0.0%
Mbulimi operativ- €	833,307.07 €	1,053,005.67 €	- 219,698.60 €	-20.9%	992,625.00 €	- 159,317.93 €	-16.1%
INVESTIMET- KRU	495,309.97 €	600,422.04 €	- 105,112.07 €	-17.5%	850,500.00 €	- 355,190.03 €	-41.8%

8.2 CAQET – ARRU – KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A-PRIZREN

Tabela nr. 13 – Performanca - Caqet- ARRU-2023

MUAJI	CAQET- ARRU- 2023	JAN-DHJETOR - 2023	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	18,463,049	31,335,811	12,872,762	69.72
<i>Faturimi m3</i>	9,599,415	8,071,139	(1,528,276)	(15.92)
<i>Faturimi Total €</i>	6,106,833.00 €	5,087,437.63 €	- 1,019,395.37 €	(16.69)
<i>Inkasimi Total €</i>	5,718,180.00 €	5,000,712.01 €	- 717,467.99 €	(12.55)
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	61,097	58,707	(2,390)	(3.91)
<i>% e inkasimit</i>	93.64	98.35	4.71	
<i>Shpenzimet</i>	4,725,555.00 €	4,204,120.04 €	- 521,434.96 €	(11.03)
<i>Uji l pafaturuar në m3</i>	8,863,634	23,264,672	14,401,038	162.47
<i>Uji l pafaturuar ne %</i>	48.01	74.24	26.24	
<i>Mbulimi operativ</i>	1.21	1.19	-0.02	
<i>Mbulimi operativ -€</i>	992,625.00 €	796,591.97 €	- 196,033.03 €	(19.75)
INVESTIMET- KRU	850,500.00 €	495,309.97 €	- 355,190.03 €	(41.76)

8.3 DRAFT PASQYRAT FINANCIARE – 2022-2023

K. R. U. "HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A.

Draft Pasqyra e pozitës financiare më 31 dhjetor 2023

Shënimi	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022
	(në EUR 000)	(në EUR 000)
	<hr/>	<hr/>

ASETET**Asetet jo-qarkulluese**

Prona, impiantet dhe pajisjet	4	32,103	32,352
Depozitat ne banka - pjesa afatgjate	9	-	-
Asetet e paprekshme	5	60	74
		<u>32,163</u>	<u>32,426</u>

Asetet qarkulluese

Stoqet	6	580	545
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera,neto	7	845	1,003
Paraja në dorë dhe në bankë	8	1,456	1,849
Depozitat ne banka - pjesa afatshkurter	9	-	-
Te arketueshmet e shtyera të prodhimit të energjisë		-	-
		<u>2,881</u>	<u>3,397</u>
Gjithsej asetet		<u>35,044</u>	<u>35,823</u>

EKUITETI DHE DETYRIMET**Ekuiteti i aksionarëve**

Kapitali aksionar	10	25	25
Rezervat	11	19,527	19,860
Fitimet/(Humbjet) e akumuluar		(6,091)	(6,190)
Gjithsej ekuiteti i aksionarëve		<u>13,461</u>	<u>13,695</u>

Detyrimet**Detyrimet jo-qarkulluese**

Huamarrjet – pjesa afatgjatë	12	-	-
------------------------------	----	---	---

Grantet e shtyera	13	20,082	20,121
	14	-	-
Detyrimet e shtyera tatimore	25	-	-
		20,082	20,121
Detyrimet qarkulluese			
Huazimet – pjesa afatshkurtër	12	-	-
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	15	1,388	1,902
Tatimi ne te ardhura I pagueshem		-	-
Detyrimet tjera		48	38
Provizionet	16	65	66
		1,501	2,006
Gjithsej detyrimet		21,583	22,127
Gjithsej kapitali dhe detyrimet		35,044	35,822

U.D. Kryeshef Ekzekutiv

Fadil Berisha

Zyrtar Kryesor Financiar

Ruzhdi Baftjaraj

K. R. U. " HIDROREGJIONI JUGOR " SH.A.

Draft Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023

Shënimi	në EUR (000)	
	Me 31 Dhjetor 2023	Me 31 Dhjetor 2022

Të hyrat nga shitjet	17	5,495	5,274
Të hyrat nga grantet	18	380	368
Te hyrat nga subvencionet		14	-
Të hyrat tjera	19	22	237
		<u>5,911</u>	<u>5,879</u>
Shpenzimet operative			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	4,5	(1,291)	(1,258)
Shpenzimet e personelit	20	(2,880)	(2,487)
Energjia elektrike	21	(1,016)	(935)
Shpenzimet e mirëmbajtjes		(233)	(216)
Shpenzimet e prodhimit të ujit		(43)	(62)
Provizionet ligjore	6	-	(66)
Humbjet nga zhvlerësimi/Lirimi i të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera		(166)	(481)
Shpenzimet e derivateve	14	(90)	(135)
Shpenzimet e tjera operative	22	(394)	(262)
		<u>(6,113)</u>	<u>(5,902)</u>
Fitimi nga operacionet		(202)	(23)

Shpenzimet/ (të hyrat) financiare,neto	23	(32)	(36)
Fitimi para tatimit		(234)	(59)
Tatimi në fitim	24	-	-
Fitim neto për vitin		(234)	(59)
Te hyra tjera gjithëpërfshirëse për vitin			
Zërat që nuk klasifikohen në fitim apo humbje			
Te ardhurat e liruara nga rivlerësimi i pronës, impianteve dhe paisjeve	25	333	343
Gjithsej te hyra gjithëpërfshirëse për vitin		99	284

IX DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS

9.1 KOMENTET KRYESORE

- Identifikimi i mangësive dhe zbrazësive të Rregulloreve të Kompanisë.
- Përgatitja e Rregullores së Kompanisë për pagat;
- Autorizime të ndryshme për përfaqësime dhe për punë tjera;
- Takime zyrtare me Përmbartuesit Privat, ku janë diskutuar problemet me të cilat ballafaqohemi gjatë punës;
- Përfaqësime të Kompanisë në Gjykatë;
- Propozime për Përmbartim, Përgjigje në Prapësim, Konstatime, Vendime, Autorizime, Marrëveshje, Kërkesa, Njoftime, si dhe shkresa tjera të cilat i kemi adresuar tek institucionet e ndryshme;

Raport i numrit të punëtorëve Janar - Dhjetor, 2023

Tabela nr. 14 – Numri i punëtorëve -2023

Muaji	Hidroregjioni Jugor	Prizren					Suharekë	Dragash	Malishevë
		Prizren	Bordi	ITUN	Praktikant	Total			
Janar	327	221	6	16		243	34	16	34
Shkurt	326	220	6	16		242	34	16	34
Mars	327	221	6	16		243	34	16	34
Prill	327	221	6	16		243	34	16	34
Maj	325	219	6	16		241	34	16	34
Qershor	322	217	6	16		239	34	16	33
Korrik	330	211	6	21	9	247	34	16	33
Gusht	329	208	6	23	9	246	34	16	33
Shtator	329	208	6	23	9	246	34	16	33
Tetor	328	207	6	23	9	245	34	16	33
Nëntor	327	206	6	23	9	244	35	16	32
Dhjetor	325	205	5	23	9	242	35	16	32

9.2 ZYRA LIGJORE

LËNDËT TË CILAT KËRCËNOJNË KOMPANINË

Tabela nr. 15 –Lendët që kërcënojnë kompaninë -2023

Nr.	Kontesti	Vërejtje
1.	Padi për kompensim dëmi.	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë
2.	Padi – Kontest nga marrëdhënia e punës	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë
3.	Padi – kompensim dëmi	Gjykata Themelore e Prizrenit me Aktgjykim e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, dhe tani Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.
4.	Padi – kompensim dëmi	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë
5.	Padi – Kontest pronësor	Gjykata Themelore e Prizrenit me Aktgjykim e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, dhe tani Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.
6.	Padi – Kontest pronësorë	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren – dega Dragash
7.	Padi – Kontest pronësorë	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren – dega Suharekë
8.	Padi për kompensim dëmi	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
9.	Padi – Kontest nga marrëdhënia e punës	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.
10.	Padi – Kontest nga marrëdhënia e punës	Lënda gjendet në Gjykatën E apelit në Prishtinë
11.	Propozim për përmbarim	Në Gjykatën Themelore në Prizren

12.	Padi për anulim të Vendimit Nr.930/20	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren-Dega në Suharekë
13.	Padi për kompensim dëmi	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren-Dega në Suharekë
14.	Padi për anulim të Vendimit Nr.2707/18	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ.
15.	Padi për kompensim dëmi	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
16.	Padi për shkak të anulimit të vendimit Nr. 2390, dt. 14.07.2023	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm
17.	Padi për pasurim të pabazë	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm
18.	Padi për shkak të anulimit të vendimit Nr. 2410, datë 18.07.2023	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm
19.	Padi për shkak të pronësisë në bazë të ndërtimit dhe parashkrimit fitues. Vlera e kontestit 3,100.00 Euro	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm
20.	Padi për kompensim dëmi në vlerë prej 3500 Euro	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
21.	Padi për kontest nga marrëdhënia e punës – Anulim të Vendimit të BD	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
22.	Padi për kontest nga marrëdhënia e punës – Anulim të Vendimit të BD	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
23.	Padi për shkak të dëmtimit, kthimit në gjendjen e mëparshme dhe kompensim dëmi në vlerë prej 3500 Euro	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm

10.1 KOMENTET KRYESORE

10.1.1 FUSHËVEPRIMI I DEPARTAMENTIT TË -ITUN

1. STATUSI I PROJEKTEVE

1.1. Statusi i projektit Faza -I-

Ndërtimi i kolektorit kryesor dhe interceptoreve në rrugë, ana e djathtë e rrjedhjes së Lumbardhit

Sa i përket statusit të projektit për Fazën I, është përpiluar raporti përfundimtar që do të përmbledhë edhe fazën I edhe fazën II dhe është miratuar nga KfW. Ky raport nënkupton se projekti për fazën I ka përfunduar dhe i gjithë dokumentacioni përkatës do të dërgohet në kontabilitet në mënyrë që të regjistrohet si aset i përhershëm i kompanisë.

1.2. Statusi i projektit të ITUN-se Faza-II-

Dizajnimi, Furnizimi dhe Ndërtimi i Impiantit për Trajtimin e Ujerave të Ndotura në Prizren

Sa i përket statusit të projektit për Fazën II, ashtu siç është cekur në raportet e mëparshme, të gjitha punimet të parapara në kontratë, kanë përfunduar.

Bazuar në raportin e konsulencës, dërguar në muajin Tetor/2023, materiali për objektin nr.57 është furnizuar tërësisht.

Të gjitha procedurat e zhvillimit të projektit për Fazën 2 janë pasqyruar dhe vërtetuar në raportin përfundimtar të projektit i cili është miratuar nga KfW.

Pasi që tani me është miratuar raporti përfundimtar, kontraktori e gëzon të drejtën që të kërkojë certifikatën e performancës dhe e njëjta i është lëshuar në muajin dhjetor. Kontraktori pas 56 ditëve kur i lëshohet certifikata e performancës është i obliguar që të lëshoj një deklaratë me shkrim se gjithçka ka përfunduar, për sa i përket këtij projekti ose të paraqes pretendimet e tija të mundshme, nëse punëdhënësi ka ndonjë obligim shtesë ndaj kontraktorit. Në momentin e lëshimit të kësaj deklaratë konsiderohet se kontrata në mes të palëve ka përfunduar.

1.3. Statusi i projektit Masat Shoqëruese

Shërbimet konsulente për ngritjen institucionale dhe atë teknike për HRJ-në

Sa i përket statusit të projektit Masat Shoqëruese, ju njoftojmë se raporti përfundimtar i përpiluar nga kontraktori konsulent DORSCH është miratuar nga KfW dhe si i tillë është i gatshëm për tu dorëzuar në kontabilitet për regjistrim.

Projektet për Fazën 1 dhe Fazën 2 si dhe projekti i Masave Shoqëruese kanë përfunduar dhe Raportet përfundimtare për të tri projektet janë miratuar nga KfW si investitor kryesor. Pasi që këto raporte përfundimtare janë miratuar nga KfW si investitor, nësi punëdhënësi, këto raporte përfundimtare dhe të gjithë dokumentacionin tjetër përcjellës do të dërgojmë në kontabilitet dhe pastaj do të vazhdohet me procedurat e më tutjeshme.

1.4. Statusi i projektit "Rehabilitimi i rrjetit te kanalizimit ne qytetin e Prizrenit faza V dhe VI

Ky projekt është bere i mundur falë bashkëpunimit ndërqeveritar të Republikës së Kosovës dhe Republikës Federale Gjermane, përmes KfW-se, e cila pandërprerë ka financuar projektet kryesore për qytetet e Prizrenit. Një ndër kushtet e përfitimit të këtij garanti ka qenë edhe vendosja e rrjetit te kanalizimit në gjeorefernc, konkretisht në sistemin e GIS-it me te gjitha imputet teknike, kjo është realizuar nga Departamenti ynë.

Emri i Projektit:	REHABILITIMI I RRJETIT TE KANALIZIMIT PER QYTETIN E PRIZRENIT
Nënshkrimi I kontratës:	07 Nëntor 2022
Data e fillimit:	21 Nëntor 2022
Vlera e Kontratës:	4,297,232.00 Euro
Kompletimi i projektit:	18 muaj ose 547 ditë nga data e fillimit
Agjncioni financues:	KfW-Banka Gjermane për Zhvillim
Detyrat e kontrates:	Ndrrimi i rrjetit te kanalizimit duke filluar nga Ø150mm deri në Ø 800 mm
Gjatësia e ndërrimit të kanalizimit:	Rreth 7.5 km
Zona e projektit:	Qyteti i Prizrenit, zonat problematike në aspektin e funksionimit
Përfitues:	KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.a
Mbikëqyrja:	Konsulenca e projektit SRP&Hidroing
Fillimimi punimeve ne teren:	28.03.2023
Koha aktuale e kontratës:	402 ditë
Ditët e mbetura:	145 ditë
Koha e përfundimit:	21.05.2024
Periudha e defekteve DNP	21.05.2025

XI MASAT E PROPOZUARA - 2024

- Rritja e transparencës
(Raportime te sakta për gjendjen e prodhimit dhe te furnizimit në gjithë regjionin)
- Inicimi i procedurave për vendosjen dhe instalimin e ujëmatësit kryesorë të prodhimit
- Përmirësimi i furnizimit në gjithë zonën e përgjegjësisë
(Plotësimi i standardeve të shërbimeve)
- Ruajtje dhe rritja e sigurisë së kualitetit të ujit të pije
(Inicimi i procedurave për ndërtimin e objektit të klorinatorëve)
- Përmirësimi disiplinës në punë
- Rritja e përgjegjësisë dhe llogaridhënia
(Caktimi i caqeve të performancave për të gjitha shërbimet dhe Njësitë operative)
- Funkcionalizimi i qendrës së thirrjeve pa pagese për konsumatorë
- Zvogëlimi i humbjeve të ujit
(se paku deri në 5% në fund të vitit 2024)
- Përgatitja e Planit të veprimit për zvogëlimin e UPF-së
- Rishikimi i Strategjisë për zvogëlimin e UPF-së
- Përgatitja e draft projekteve për vendosjen e ujëmatësive
- Përmirësimi i furnizimit në gjithë zonën e përgjegjësisë
- Rritja e bashkëpunimit me Donatorët, Qeverinë dhe Kuvendet Komunale
- Rishikimi i planit të investimeve
- Përgatitja dhe inicimi me kohë i projekteve kapitale
- Digjitalizimi i shërbimeve, rrjetit dhe pikave kryesore të prodhimit
- Rishikimi dhe përgatitja e projekt propozimeve për projektet e pa përfunduara nga donatorët
- Marrëveshjet e bashkëfinancimit të projekteve me Kuvendet Komunale
- Planifikimi i trajnimeve profesionale
- Përmirësimi i komunikimit me konsumatorë
- Rritja e aktiviteteve me Media
- Organizimi i fushatave senzibilizuese (shkolla, universitet, vende publike, etj)
- Plotësimi i punëtoreve në operative- pranimi i punëtoreve nga enti për punësim
- Pranimi i praktikanteve nga shkolla teknike
- Rishikimi i planit të biznesit

